

TITULLI I KURSIT: Kulturë shkrimi

Niveli dhe lloji i kursit: Master – i detyrueshëm
Programi: Master ne Kurikulë
Viti i studimeve: I
Numri i orëve në javë: 3 orë
Kodi – shifra e lëndës: Edu 109 D
Vlera në kredi ECTS: 6
Koha – lokacioni: Semestri veror 2014 - Fakulteti i Edukimit

Mësimdhënësi: Prof. dr. Begzad Baliu
E-mail: bbaliu@yahoo.com

PËRSHKRIMI I KURSIT

Kursi përfshin një lëndë të rëndësishme nga fusha e kulturës së gjuhës në përgjithësi e të kulturës në të shkruar në veçanti, që i mundësonë studentit të fitojnë kulturë në ligjërimin e lidhur (në gjuhën e folur dhe në atë të shkruar). Në këtë kurs do të trajtohen mësimet teorike dhe praktike të shkrimeve akademike: *ese, punim seminari, punim diplome, të shkruarit e tekstit (librit – monografisë), punim maisteri/doktorate* etj., si dhe shkrimet funksionale – shkrimet praktike (letra, përmbledhja (shkurtojra), kumtesa për shtyp, relacioni, procesverbali, libreci (broshura), fletëpalosja (deplianti), njoftimet (qarkoret), “Curriculum vitae” (CV-ja), citimet, bibliografia; të shkruarit si mjet informacioni etj.

Tema trajtimi do të jenë edhe: standardi gjuhësor dhe disa probleme rreth tij; ndikimi i faktorëve jashtëgjuhësorë mbi normën gjuhësore; disa çështje fonetik-morfologjike (drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi (fonetik) i gjuhës; drejtpërdorimi i fjalëve me prejardhje të huaj dhe emrat e përveçëm të huaj, emrat gjeografikë; drejtshkrimi i shumësit të emrave dhe të mbiemrave; shkrimi i nyjës së përparme... dhe çështjet leksikore (tautologjia, kalket dhe mundësia e mënjanimi të tyre; fjalët e huaja dhe zëvendësimi i tyre etj. - kryesisht përmes shembujve praktikë), e e tërë kjo për një ngritje në shkallë sa më të lartë të kulturës në të shkruar e në të folur. Po ashtu studentët do të mësojnë për hartimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme profesionale-shkencore, si dhe të formave të komunikimit profesional etj., gjithnjë duke u mbështetur në shqipen standarde.

Për ta përvetësuar në nivel sa më të mirë këtë kurs, studentët do të zbatojnë shkrimin dhe leximin e punimeve me shkrim gjatë orëve të mësimi dhe përmes detyrave të shtëpisë. Nga ata do të kërkohet të mbajnë një portfolio të punimeve të tyre me shkrim, të cilat do t'i bëjnë gjatë kursit.

Ligjëratat, seminarat, diskutimet, puna në grupe, hulumtimet, literatura e përcaktuar, zbatimi i strategjive dhe i teknikave të reja mësimore, mbështetin studentin për të fituar njohuri e zotësi më të mira për një mësim më të avancuar në kulturë të shkrimit dhe në atë të standardit gjuhësor.

OBJEKTIVAT E KURSIT

- Të përvetësojë studenti teorikisht dhe praktikisht shkrimet akademike: *ese, punim seminari, punim diplome, të shkruarit e tekstit, punim maisteri* etj. dhe shkrimet funksionale e të shkruarit si mjet informacioni etj.;
- të mësojë për standardin gjuhësor dhe disa probleme rreth tij: ndikimi i faktorëve jashtëgjuhësorë mbi normën gjuhësore; disa çështje fonetik-morfologjike (drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi (fonetik) i gjuhës; drejtpërdorimi i fjalëve me prejardhje të huaj dhe emrat e përveçëm të huaj, emrat gjeografikë; drejtshkrimi i shumësit të emrave dhe të mbiemrave; shkrimi i nyjës së përparme... dhe çështjet leksikore (tautologjia, kalket dhe mundësia e mënjanimi të tyre; fjalët e huaja dhe zëvendësimi i tyre etj.), e e tërë kjo për një ngritje në shkallë sa më të lartë të kulturës së në të shkruar e në të folur;
- të pajiset studenti me informacione mbi procesin e shkrimit, teknikat më të mira të shprehësisë e të përzgjedhjes metodologjike, që kërkojnë një rrjet të strukturuar mirë arsyetimi;
- të fitojë aftësi për t'i dalluar trajtat normative nga ato jonormative, në të shkruar dhe në të folur, në mënyrë që këto aftësi t'i zbatojë me sukses në karrierën e tij profesionale;
- të aftësohet për komunikim të lirshëm në situata të ndryshme;

- t'i formulojë me gojë dhe me shkrim mendimet e tij dhe t'i hetojë dallimet kuptimore leksikore ndërmjet dialekteve dhe gjuhës standard etj.;
- të nxitet te studenti të menduarit e sistemuar e i qartë, i mbështetur në të folurit e rrjedhshëm;
- të forcohet aftësia dhe zotësia te ai për të ndërtuar e zhvilluar pikëpamje gjatë proceseve të vështira të të menduarit, duke përdorur mjetet e mekanizmat e përvetësuar;
- të edukojë kulturën dhe etikën e kërkimit, nevojën për shkëmbimin e përvojës, ndjenjën e komunikimit të frytshëm me audiencën;
- të thellojë njohuritë gjuhësore, veçanërisht në rrafshin frazeologjik, në zgjerimin e fondit të fjalëve, në njohjen më të mirë të kuptimit të tij, në zëvendësimin e qemtuar të fjalëve të huaja me fjalë shqipe, në zbatimin e strukturës së natyrshme sintaksore të shqipes, e sidomos, në kujdesin drejtshkrimor dhe drejtshqiptimor.

REZULTATET E PRITURA NGA KURSI

Në fund të këtij kursi, pritet që studenti të jetë në gjendje:

- të ketë njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të shkruar në mënyrë akademike;
- të ushtrojë aftësinë e të menduarit të arsyeshëm dhe të dijë ta vendosë tezën brenda një teksti të argumentuar;
- të analizojë dhe të vlerësojë fuqinë e argumentit të shkruar;
- të kuptojë konceptet themelore të hulumtimit;
- të shkruajë në mënyrë efektive për audiencë të posaçme;
- të dijë si t'i sistemojë idetë dhe fragmentet e huazuara të tekstit sipas sistemeve ndërkombëtare të të cituarit;
- të përdorë me sukses gjuhën e shkruar standarde në komunikim me shkrim dhe me gojë;
- të jetë i gatshëm të shfrytëzojë përdorimin e kujdesshëm të burimeve gjatë të shkruarit;
- të shkruajë lloje të ndryshme shkrimi dhe të ketë aftësi të mira në të shkruar;
- të jetë në gjendje të mënjanojë fjalët dhe konstruktet e huaja e të panevojshme;
- të përvetësojë disa koncepte themelore të rendit gjuhësor, të lidhura kryesisht me drejtshkrimin e gjuhës standarde shqipe dhe me normën e saj.

PLANI I DETAJIZUAR I PROGRAMIT TË KURSIT

JAVA E MBAJTJES SË LIGJËRATËS	TEMAT QE TRAJTOHEN NË ORËT MËSIMORE	LITERATURA (TË CILËN STUDENTËT DUHET TA LEXOJNË PARA ORËS MËSIMORE)	DETYRAT (APO AKTIVITETET QË DO TË VLERËSOHEN NË ORËT MËSIMORE) DHE ATO QË JEPEN PËR D. SH.
JAVA I	Paraqitja e kursit <i>Kulturë shkrimi</i>: qëllimi, detyrat dhe rëndësia e tij. Procesi i të shkruarit. Llojet dhe mënyrat e shkrimit të esesë dhe të paragrafëve: <i>eseja treguese; eseja përshkruese;</i>	1. Thomas S. Kane, QAD, Tiranë, 2010. <i>Si të Shkruajmë shqip</i> , (Përkthyer e përshtatur nga Majlinda Nishku & Xhevat Lloshi), f. 23-240. 2. Bardhyl Musai, <i>Si të shkruajmë ese</i> (paragrafët, pyetjet dhe vlerësimi), QAD, Tiranë, 2007, f.129-206. 3. Majlinda Nishku, <i>Si të shkruajmë</i> (procesi dhe shkrimet funksionale), QAD, Tiranë, 2004, f. 37-40.	Çdo student ka për detyrë shtëpie të shkruajë një nga esetë e mësuar (sipas zgjedhjes)

<p>JAVA II</p>	<p>Eseja shpjeguese, eseja e krahasimit-kontrastit; eseja argumentuese - bindëse (përmes shembujve)</p>	<p>1. Thomas S. Kane, vepra e cituar, f.23-240. 2. Bardhyl Musai, <i>Si të shkruajmë ese</i> (paragrafët, pyetjet dhe vlerësimi), QAD, Tiranë, 2007, f.129-206 3. Majlinda Nishku, Vepra e cituar, f.37-40.</p>	<p>Jepen punime seminari. Secili e punon seminarin me shkrim në shtëpi. Seminarët i dorëzohen profesorit të lëndës (gjatë semestrit) drejtpërdrejt ose përmes formës elektronike. Seminari (dhe detyrat e tjera me shkrim) hartohet me fontin 12, Times New Roman. referencat dhe citimet duhet të shkruhen sipas standardit APA. Punimi i pranuar shënohet në fund të indeksit.</p>
<p>JAVA III</p>	<p>Si të shkruajmë një punim shkencor (shkrimi i punimit, struktura, citimet, plagjiatura, bibliografia)</p>	<p>1. Elona Boce, <i>Si të shkruajmë një punim kërkimor</i>, QAD, Tiranë, 2004, f.19-76. 2. Gjovalin Shkurtaj, <i>Si të shkruajmë shqip</i> (nga drejtshkrimi të shkrimit profesionale), Toena, Tiranë, 2008, f. 202-223. 3. Rami Memishaj, <i>Shqipja standarde</i> (Si ta flasim dhe ta shkruajmë), Toena, Tiranë, 2005, kap. I.</p>	<p>Të hartuarit e një eseje në klasë (i caktuar nga mësimmshënësi)</p>
<p>JAVA IV</p>	<p>Të shkruarit e seminarit, të diplomës, të tezës së masterit/doktorates, të monografisë</p>	<p>1. Gjovalin Shkurtaj, <i>vepra e cituar</i>, f. 19-56 dhe 202-223. 2. Ecco, U. (1997). <i>Si shkruhet një punim diplome</i>, Copyright RCS Libri S.p.A.-Milano, B. (për botimin shqip, <i>Dituria</i> 2006, përktheu Shpëtim Çuçka). 3. Rami Memishaj, vepra e cituar, kap. I.</p>	<p>Çdo student për detyrë shtëpie ka të shkruajë CV-inë e tij/saj</p>
<p>JAVA V</p>	<p>Shkrimet praktike – funksionale (shkrimet praktike (letra, përmbledhja (shkurtorja), kumtesa për shtyp, procesverbali, libreci (broshura) dhe fletëpalosja (deplianti); (njoftimet (qarkoret), Curriculum vitae” (shkurt: CV-ja).</p>	<p>1. Gjovalin Shkurtaj, <i>Vepra e cituar</i>, f. 183-201. 2. Mr. Zijadin Munishi, <i>Gjuha shqipe dhe kultura e të shprehurit</i> (për kl. III-IV të AMO-së), Prishtinë, 1984</p>	<p>Vlerësimi I me shkrim</p>
<p>JAVA VI</p>	<p>Drejtshkrimi i zanoreve (me theks të veçantë i zanores ë) dhe i grupeve të zanore; drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve dhe i grupeve të bashkëtingëlloreve.</p>	<p>1. Grup autorësh, <i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i>, Prishtinë, 1974, kap. I-II. 2. Rami Memishaj, <i>Shqipja standarde</i> (Si ta flasim dhe ta shkruajmë), Toena, Tiranë, 2005, kap. II,III,IV.</p>	<p>Të jepen detyra shtëpie përkitazi me ligjëratën e realizuar: 10 fjali me shembuj ku ë-ja nuk është përdorur me vend dhe 5 jali ku ka pasur ngatërrim të bashkëtingëlloreve – vjel nga shtypi</p>
<p>JAVA VII</p>	<p>Drejtshkrimi i shumësit të emrave dhe të</p>	<p>1. Rami Memishaj, <i>Shqipja standarde</i> (Si ta flasim dhe ta shkruajmë),</p>	

	mbiemrave , problemi i shkrimit të nyjës së përparme.	Toena, Tiranë, 2005, kap. II. 2. Grup autorësh, <i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , Prishtinë, 1974, kap. IV	
JAVA VIII	Përemri: llojet dhe gabimet kryesore që bëhen gjatë përdorimit të tyre – sidomos i trajtave të shkurtra të përemrit vetor	1. Rami Memishaj, <i>Shqipja standarde</i> (Si ta flasim dhe ta shkruajmë), Toena, Tiranë, 2005, kap. III. 2. Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, <i>Gjuhë amtare</i> për studentët e Fakultetit të Edukimit, UP, Prishtinë, 2010, f. 204-220.	Nga mjetet e shkruara ose elektronike të informimit, studentët kanë për detyrë të shkruajnë nga 10 shembuj të përdorimit gabim të përemrave (2 shembuj me trajta të shkurtra dhe 2 shembuj me trajta të bashkuara të p. vetor) dhe nga 3 shembuj të përemrave pronorë dhe pyetës)
JAVA IX	Folja: klasat e foljeve dhe gabimet kryesore që bëhen gjatë zgjedhimit të tyre	1. Zijadin Munishi, <i>Zgjedhimi i foljeve</i> , Libri shkollor, Prishtinë, 1998. 2. Rami Memishaj, vepra e cituar, kap. IV, f. 83-97. 3. Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, <i>Gjuhë amtare</i> për studentët e Fakultetit të Edukimit, UP, Prishtinë, 2010, f. 232-249.	
JAVA X	Përdorimi i shkronjave të mëdha; të shkruarit e datave; shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes; përdorimi i shenjave të pikësimit.	1. Grup autorësh, <i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , Prishtinë, 1974, kap. VI, VIII. 2. Gjovalin Shkurtaj, <i>Vepra e cituar</i> , f. 227-234. 3. Rami Memishaj, vepra e cituar, kap. I	Detyrë shtëpie: të shënohen datat e shkruara gabimisht në ekranet e televizioneve tona
JAVA XI	Drejtshkrimi i fjalëve me prejardhje të huaj dhe i emrave të përveçëm të huaj, drejtshkrimi i emrave gjeografikë etj.	1. Grup autorësh, <i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , Prishtinë, 1974, kap. III. 2. Dr. Qemal Murati, <i>Standardi gjuhësor dhe kultura e shprehjes</i> , Prishtinë, 2004, f. 282-297.	Nga mjetet e shkruara ose elektronike të informimit, studentët kanë për detyrë të nxjerrin nga disa fjalë të huaja të zëvendësueshme në gjuhën shqipe
JAVA XII	Rreth disa kalkeve (huazime strukturore e leksikore në gjuhën shqipe) dhe drejtpërdorimi	1. Gjovalin Shkurtaj, <i>Vepra e cituar</i> , f.245-277. 2. Dr. Bahtijar Kryeziu, <i>Si të</i>	Të shkruajnë si detyrë shtëpie së paku nga 10 fjalë tautologjike dhe 10 fjalë sinonime të përd-

	i fjalëve sinonimike dhe tautologjive.	<i>flasim dhe si të shkruajmë drejt, Prishtinë, 2006, LSh., f.98-126 dhe Shqipja e sotme – këndvështrim teoriko-praktik, f. 234-242.</i> 3. Dr. Qemal Murati, Standardi gjuhësor dhe kultura e shprehjes, Prishtinë, 2004, f. 64-69 dhe 331-338	rura gabimisht ne përditshmërinë tonë
JAVA XIII	Fjalìa: llojet e fjalive; stili i fjalive të përbëra (periudhës)	1. Thomas S. Kane, f. 348-431; 2. Rami Memishaj, vepra e cituar, kap. V. 3. Prof.dr.Ali Jashari – Prof.asc.Bahtijar Kryeziu, <i>Gjuhë amtare</i> për studentët e Fakultetit të Edukimit, UP, Prishtinë, 2010	
JAVA XIV	Zgjedhja e fjalëve në fjali; shmangie e fjalëve të panevojshme	Thomas S. Kane, vepra e cituar, faqe 474-528	Të jepen detyra shtëpie ku studentët do të gjejnë fjali me fjalë të tepërta, të cilat duhet hequr për të pasur thuktësi të fjalit
JAVA XV	Shenjat e korrektimit	1. Rami Memishaj, vepra e cituar, kap. I dhe faqe 181 - 198.	Vlerësimi II me shkrim

DETYRAT E KURSIT

Duhet të ketë së paku katër detyra kryesore, pos atyre të shtëpisë, të cilat vlerësohen në mënyrë që studenti të ketë gjasa të mira për sukses. Secila detyrë është e detajizuar në përshkrimin e kursit. Kolona e *datës së afatit* përfshin datën në të cilën studentët duhet të dorëzohet detyra, qoftë në letër në orën mësimore, qoftë në mënyrë elektronike përmes e-mailit. Kolona e *përqindjes* është shuma me të cilën kontribuon (ndihmon) studenti drejt notës përfundimtare të kursit prej 100 %.

DETYRA (E CILA DO TË VLERËSOHET)	PËRSHKRIMI	AFATI I KYERJES SË DETYRËS	%																																												
<p>Një</p> <p>Të hartuarit e esesë</p>	<p><i>Të hartuarit e esesë.</i></p> <p>Studentët e hartojnë në mënyrë individuale esenë, duke e zgjedhur vetë temën dhe llojin e esesë. Punimi i esesë bëhet në klasë.</p> <p>Eseja ngërthen në vete 100 pikë të mundshme, ku tërësia e pikëve të saj përbën 15% të pikëve të vlerësimit përfundimtar.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;">Kriteret</th> <th style="text-align: center;">Jo mirë</th> <th style="text-align: center;">Mirë</th> <th style="text-align: center;">Shkëlq.</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Titulli</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Paragrafi hyrës</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Fjalitë hyrëse në paragraf janë të qarta.</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Ka koherencë ndërmjet paragrafëve.</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Fjalitë kanë lidhje logjike e gjuhësore.</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Janë respektuar shenjat e pikësimit.</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Fjalori është i qëlluar.</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Ka qartësi kuptimore.</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Përfundimet janë të qarta.</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Është konsultuar literaturë dhe burime të tjera</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Kriteret	Jo mirë	Mirë	Shkëlq.	Titulli				Paragrafi hyrës				Fjalitë hyrëse në paragraf janë të qarta.				Ka koherencë ndërmjet paragrafëve.				Fjalitë kanë lidhje logjike e gjuhësore.				Janë respektuar shenjat e pikësimit.				Fjalori është i qëlluar.				Ka qartësi kuptimore.				Përfundimet janë të qarta.				Është konsultuar literaturë dhe burime të tjera				<p>Në javën e tretë</p>	<p>15%</p>
Kriteret	Jo mirë	Mirë	Shkëlq.																																												
Titulli																																															
Paragrafi hyrës																																															
Fjalitë hyrëse në paragraf janë të qarta.																																															
Ka koherencë ndërmjet paragrafëve.																																															
Fjalitë kanë lidhje logjike e gjuhësore.																																															
Janë respektuar shenjat e pikësimit.																																															
Fjalori është i qëlluar.																																															
Ka qartësi kuptimore.																																															
Përfundimet janë të qarta.																																															
Është konsultuar literaturë dhe burime të tjera																																															
<p>Dy</p> <p>Testi 1 organizohet në javën e pestë</p>	<p><i>Testi i parë me shkrim.</i></p> <p>Testi përmban materien e zhvilluar që nga java e parë gjer në të pestën.</p> <p>Testi punohet në mënyrë individuale.</p> <p>Testi ka 20 pyetje. Secila pyetje vlerësohet prej 0 – 5 pikë. Tërësia (totali) e pikëve të këtij testi jep 25% të pikëve të vlerësimit përfundimtar.</p>	<p>Në javën e pestë.</p>	<p>30%</p>																																												

Tre	<i>Punim seminari.</i> Jepen temat e seminarit për secilin student veç e veç. Ato i punojnë në shtëpi. Seminari punohet me shkrim, por edhe mund të diskutohet gojarisht para grupeve të tjera. Punimi i seminarit vlerësohet deri në 100 pikë, ndërsa këto 100 pikë përbëjnë 20 % të pikëve për vlerësimin përfundimtar.	Nga java III - XIV	15%
Katër Testi 2 organizohet në javën e trembëdhjetë	<i>Testi i dytë me shkrim.</i> Përfshin materien e zhvilluar që nga java e gjashtë gjer në të dymbëdhjetën. Ai ngërthen temat prej 6-15. Punohet individualisht. Përbëhet prej 20 pyetjesh. Secila pyetje vlerësohet prej 0 – 5 pikë. Tërësia (totali) e pikëve të këtij testi jep 30% të pikëve të vlerësimit përfundimtar.	Java e pesëmbëdhjetë	30%
Pesë Angazhimi në klasë dhe detyrat e shtëpisë	Studentët do të marrin pikë edhe nga angazhimi i tyre në punë klase dhe nga detyrat e shtëpisë. Ky angazhim vlerësohet me 10% të pikëve.	Nga java II – XV	10%
			Totali 100%

Konvertimi i pikëve në nota:

1	91- 100	10
2	81-90	9
3	71-80	8
4	61-70	7
5	51-60	6
6	0-50	5

L I T E R A T U R A

1. Kane, S. Thomas (2010), *Si të shkruajmë shqip*, (Përkthyer e përshtatur nga Majlinda Nishku & Xhevat Lloshi) Tiranë: QAD.
2. Shkurtaj, Gjovalin (2008), *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë: Toena.
3. Musai, Bardhy (2007), *Si të shkruajmë ese* (2004). Tiranë: QAD (CDE)
4. Nishku, Majlinda (2004) *Procesi dhe shkrimet funksionale*, Tiranë: (CDE) QAD
5. Boce, Elona (2004), *Si të shkruajmë një punim kërkimor*, Tiranë: QAD (CDE)
6. Eco, Umberto (1997), *Si shkruhet një punim diplome*, Copyright RCS Libri S.p.A.- Milano, B. (për botimin shqip, *Ditura* 2006, përktheu Shpëtim Cuçka).
7. Grup autorësh (1974), *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë: IAP.
8. Ismajli, Rexhep (2003), *Standarde dhe identitete*, Pejë: Dukagjini.
9. Memishaj, Rami (2005), *Shqipja standarde*, Tiranë: Toena.
10. Murati, Qemal (2004). *Standardi gjuhësor dhe kultura e të shprehurit*, Prishtinë: IAP.
11. Munishi, Zijadin (1998), *Zgjedhimi i foljeve*, Prishtinë: Libri shkollor.
12. Kryeziu, Bahtijar (2006). *Si të flasim dhe si të shkruajmë drejt*, Prishtinë: Libri shkollor.
13. Kristal, D. (1987), *The Cambridge encyclopedia of language*, Publisher: Cambridge (Cambridgeshire); New York : Cambridge University Press. .
14. Grup autorësh (1998), *Enciklopedijski rečnik moderne lingvistike*, Beograd: Nolit.
15. Jashari, Prof. dr.Ali & Kryeziu, Prof.dr. Bahtijar (Botimi II, 2011), *Gjuhë amtare për studentët e Fakultetit të Edukimit*, Prishtinë: UP.